



NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Dokumentit me nr. 6694/1 prot., datë 29.12.2023, “Manuali i Burimeve Njerëzore të OST sh.a.”, si dhe Dokumentit me nr. 3329/2 prot., datë 28.05.2021, “Detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në Njësitë Operative dhe Njësinë e Mirëmbajtje Transmetimit” (i rishikuar), OST sh.a. shpall procedurën e rekrutimit për pozicionin e mëposhtëm:

Përgjegjës Sektori në Sektorin e Sigurimit Teknik dhe Mjedisit, Njësia Operative Burrel (NJOB)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kontrollon dhe kërkon zbatimin e të gjitha masave organizative dhe teknike për punë pa rrezik të punonjësve të sektorit të mirëmbajtjes të nënstacionit (hapja e urdhërit të punës, fleta e manovrimeve etj);
- Kontrollon dhe kërkon zbatimin e të gjitha masave organizative dhe teknike për punë pa rrezik të punonjësve të sektorit të mirëmbajtjes të linjave të tensionit të lartë (hapja e urdhërit të punës, fleta e manovrimeve etj);
- Kontrollon mjetet e sigurimit teknik dhe kryen testimet periodike të tyre, të percaktuara në rregulloren e sigurimit teknik;
- Kontrollon zbatimin e masave teknike për punë pa rrezik, të marra nga brigadat e mirëmbajtjeve të linjave dhe të nënstacioneve, gjatë kryerjes së punimeve të remonteve apo punimeve të tjera që ato bëjnë në objektet e tyre;
- Ndjek afatet e kalimit në provim për njohuritë e sigurimit teknik të gjithë punonjësve të Njësisë që duhet ti kenë këto njohuri dhe paisjen e tyre me libreza të sigurimit teknik;
- Organizon ditën e sigurimit teknik me sektoret, për të përsosur njohuritë e tyre dhe i evidenton ato.

Kërkesat e përgjithshme, që duhet të plotësojë kandidati për punësim:

- Të ketë shtetësinë shqiptare;
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës sipas kriterëve të miratuara;



- Të jetë i aftë për punë;
- Të mos jetë i dënuar me një vendim gjykatë të formës së prerë;
- Të gëzojë integritet moral dhe profesional, si dhe të mos jetë marrë masa disiplinore për cënim të rregullave të etikës;
- Të mos ketë lidhje familjare me punonjës të tjerë të administratës me të cilët kanë lidhje hierarkie;
- Personat që kandidojnë për këtë pozicion, duhet të kenë të paktën 3 -vite eksperiencë pune në fusha relevante.

ARSIMI I KËRKUAR:

I larte - Inxhinieri elektrik/ (Master shkencor ose Diplome ekuivalente).

Dokumentat për dorëzim

Faza e Vlerësimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Arkivë-Protokollit, në Aparatin Qendror të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose nëpërmjet postës elektronike: info@ost.al, këto dokumente:

1. Curriculum Vitae (CV)
2. Dëftesë e arsimit të lartë
3. Çertifikime të tjera relevante

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit duhet të bëhet brenda datës 31.03.2024.

Mënyra e vlerësimit:

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.



Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.

Dokumentat për dorëzim

Faza e lidhjes së kontratës:

1. Libreza e punës (nëse ka) ose vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore
2. Fotokopje e noterizuar diplomës sëbashku me listen e notave
3. Vërtetim shëndetësor nga Komisioni Mjeko-Ligjor
4. Fotokopje ID
5. Dëshmi penaliteti
6. Vërtetim nga gjykata
7. Vërtetim nga prokuroria
8. Çertifikatë familjare
9. Dëshmi të ndryshme kualifikimi

###